

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                       |
|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Trajneri Maran, tur në Europë për të monitoruar kuqezinjtë para UEFA Nations League                                                                                                                                                                   |
| ADRESA  | <a href="https://www.gazetatema.net/sport/trajneri-maran-tur-ne-europe-per-te-monitoruar-kuqezinjte-para-uefa-nation-i584964">https://www.gazetatema.net/sport/trajneri-maran-tur-ne-europe-per-te-monitoruar-kuqezinjte-para-uefa-nation-i584964</a> |
| BURIMI  | gazetatema.net                                                                                                                                                                                                                                        |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                                |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                          |
|-----------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 9 shtator 2026, 13:01:08 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 9 shtator 2026, 14:20:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                   |
|------------|-------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | b1be848a3cd8d9d8e28ae5429775e771b007ccf976732ee5b0b0c6fa6ed08292  |
| TEKSTI     | 685eb62a05e69f43825d1900eaeab2337b1fa72914d9e04a281da8978a7bf4d71 |
| PAMJA      | 6b0e6cd60bf5e9b2627ab6ac027a3ea3ce003bb7415aa33aaed181444c7493b   |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                                                                                    |
|---------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 4695da33dc76bba202579f28ca087e87b4d98c14f1e14ed079ddfd547590cf9                                                                                                    |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                                                                                                  |
| RRËNJA MERKLE | —                                                                                                                                                                  |
| ANKORIMI      | nuk është ankoruar ende<br><i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4695da33dc76bba202579f28ca087e87b4d98c14f1e14ed079ddfd547590cf9>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by  
[Kontakt](#)

English

1e "Parlamenti të luajë rol të rëndësishëm në procesin e integritetit", zbulohen kërkesat e ambasadores së BE-sëPerplasjet vazhdojnë: Harry dhe Meghan kundërshtojnë letëren zyrtare të Mbretit Charles fundit

## Trajneri Maran, tur në Europë për të monitoruar kuqezinjtë para UEFA Nations League

9 Shtator 2026, 16:20Sport TEMA



Trajneri Maran, tur në Europë për të monitoruar

Trajneri i Kombëtares shqiptare, Rolando Maran, ka zhvilluar gjatë javës së kaluar një tur në disa vende të Europës, në kuadër të punës përgatitore për sfidat e edicionit të ri të UEFA Nations League.

Tekniku italian ka ndjekur nga afër disa prej ndeshjeve të klubeve ku aktivizohen futbollistë të Kombëtares shqiptare, me fokus të veçantë te lojtarët që nuk kanë qenë në dispozicion për dy ndeshjet miqësore të muajit qershor ndaj Izraelit dhe Luksemburgut.

Gjatë këtij turi, Maran ka monitoruar paraqitjet e futbollistëve kuqezi në Turqi, si edhe në vendet e Europës Veriore, duke pasur mundësinë të takohet nga afër me disa prej tyre dhe të diskutojë mbi formën e tyre, gjendjen fizike dhe ecurinë në klubet përkatëse. Vëzhgimi i lojtarëve në aksion me klubet e tyre është pjesë e punës së stafit teknik për të pasur një panoramë sa më të plotë të futbollistëve që mund të jenë pjesë e Kombëtares në sfidat e ardhshme.

Në javët e fundit, trajneri Maran dhe stafi i tij kanë vijuar një punë intensive monitorimi dhe analize të lojtarëve që bëjnë pjesë në listën e gjerë të Kombëtares. Vëmendja është përqendruar te forma aktuale e secilit futbollist, aktivizimi i tyre në klubet respektive dhe mundësitë që ata mund t'i ofrojnë skuadrës kuqezi.

Kjo periudhë pune do të shërbejë për të finalizuar listën e futbollistëve që do të grumbullohen për ndeshjet e para të UEFA Nations League, teksa Kombëtarja shqiptare përgatitet për një tjetër edicion ndërkombëtar. Shqipëria do ta nisë aventurën e re në UEFA Nations League më 26 shtator, në "Air Albania", ndaj Bjellorusisë. Vetëm tri ditë më vonë, më 29 shtator, kuqezinjtë do të luajnë në transfertë ndaj San Marinos.

Sfida e tretë do të zhvillohet më 3 tetor në transfertë ndaj Finlandës, ndërsa më 6 tetor Shqipëria do të rikthehet në shtëpi për përballjen e dytë ndaj San Marinos. Me përgatitjet që tashmë kanë hyrë në një fazë intensive, stafi teknik po vijon të monitorojë nga afër të gjithë lojtarët në dispozicion, me synimin për të ndërtuar grupin më të mirë të mundshëm për sfidat e Nations League.

### Lini një Përgjigje

Koment \*

Emër \*

POSTOJE KOMENTIN

[Pas 15 vitesh në Seria A doli lojtar i lirë, Elseid Hysaj drejt transferimit në kampionatin rus](#)

14:00 Sport

[Luka Modric mbush sot 41 vjeç, te Milani ende një lider dhe një shembull pa kohë!](#)

11:35 Sport

[Lorik Cana i zhgënjyer nga mbështetja për Mlladiçin: Serbia nuk po mëson nga e kaluara](#)

15:10 Sport /9 komente

[Superkompjuteri parashikon dhjetë skuadrat pretendente për Champions League 2026-2027](#)

14:10 Sport /2 komente

[Tronditet futboli gjerman, lojtari dyshohet se helmoi shokun e skuadrës për një grua](#)

13:20 Sport /3 komente

[Italia “zhduk” VAR-in, asnjë thirrje dhe asnjë penallti nga teknologjia në 30 ndeshje](#)

10:40 Sport /3 komente

[“Futbolli në Shqipëri si një luftë bandash”, shpërthen Sinan Idrizi: Përgjegjësi e Dukës](#)

20:35 Sport /2 komente

[Shkëlqen në Kroaci, Erind Cara merr medaljen e argjendtë](#)

18:31 Sport

[Mbappé kalon në sulm: Kam bërë historinë dhe meritoj “Topin e Artë”, jam lojtari më i famshëm dhe luaj për klubin më të famshëm!](#)

16:40 Sport /4 komente

[Burnley i shton konkurrencën Brojës, Jamie Vardy i bashkohet ekipit deri në fund të sezonit](#)

14:50 Sport /3 komente

## **Më të lexuarat**

**24 orët e fundit**

**Javën e fundit**

[Berisha vijon turin në SHBA, mbështetësi nga Teksasi: U b...](#)

14:15 Politika /53 komente

[FOTO: Marjana Koçeku iu bashkohet deputetëve të Sali Ber...](#)

17:35 Politika /110 komente

**Nga Banka e Shqipërisë tek Parlamenti Evropian, punësimet...**

14:50 Politika / 10 komente

**Do blinte toka në Shqipëri, do investonte në Bogovë dhe u...**

22:50 Kronika / 4 komente

**Incidenti me disa protestuese, reagon Iris Luarasi: Do e ...**

19:40 Politika / 118 komente

**Blog Tema**

**Pandeli Majko: Liria nuk gjykohet...**

13:00 Blog / 1 koment

**Një debat që nuk duhet të mbarojë te telefonat**

09:45 Blog / 3 komente

**25-vjetori i Marrëveshjes së Ohrit: Maqedoni, mars-gusht 2001**

09:15 Blog / 5 komente

**Lajme ekskluzive!**

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

REGJISTROHU

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

Tema është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, Tema është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

- 
- 
- 
- 
- 

Built and Monetized by

- [Politika](#)
  - [Kronika](#)
  - [Editorial](#)
  - [Blog](#)
  - [Bota](#)
  - [Sport](#)
  - [Shëndeti](#)
  - [Turizëm](#)
  - [Kontakt](#)
  - [Te dhënat personale](#)
  - [Cookies](#)
- [Sociale](#)
  - [Ekonomia](#)
  - [Antena](#)
  - [Rajoni](#)
  - [Kulturë](#)
  - [Lifestyle](#)
  - [Dossier](#)
  - [Hi-Tech](#)

Built and Monetized by